

20121062746

L I G J
PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE TË DETYRIMEVE SIPAS
MARREVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN “MODERNIZIMI I BLOKUT 2 DHE
BLOKUT 3 NË TE BITOLLA”, QË DO TË LIDHET NDERMJET DOJÇE BANKES
DHE SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton permbushjen e detyrimeve dhe plotesimin e dispozitave të Marreveshjes për hua për projektin Modernizimi i bllokut 2 dhe bllokut 3 në TE Bitolla”, që do të lidhet ndermjet Dojçe Bankes dhe SHA ELEM në shume prej 49 232 018 eurosh, nese SHA ELEM nuk i permbushë dhe servison detyrimet nga Marreveshja për hua.

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga kjo garanci, Republika e Maqedonise dhe Dojce Banka do të lidhin Marreveshje për garanci. Ministri i Financave në emer të Republikës së Maqedonise do ta nenshkruaje Marreveshjen për garanci.

Huaja nga paragrafi 1 i ketij neni ndahet në dy pjese në shuma prej 24 864 362 eurosh dhe 24 367 656 eurosh.

Shuma prej 24 367 656 eurosh nga paragrafi 3 i ketij neni dedikohet për modernizim të bllokut 2 të TE Bitolla.

Shuma prej 24 864 362 eurosh nga paragrafi 3 i ketij neni dedikohet për modernizim të bllokut 3 të TE Bitolla.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshjen për hua, që do të lidhet ndermjet Dojce Bankes dhe SHA ELEM për projektin “Modernizimi i bllokut 2 dhe bllokut 3 në TE Bitolla”.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marreveshja për hua nga neni 1 i ketij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryeje SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afatet dhe kushtet e percaktuara në Marreveshjen për hua.

Neni 4

Huaja nga Marreveshja nga neni 1 paragrafi 1 i ketij ligji, do të paguhet në 24 keste të barabarta gjysmevjete. Pagesa duhet të filloje gjashte muaj pas dates së gatishmerise për pune të bllokut të modernizuar. Pagesa e pare e pjeses së huas për bllokun 3 duhet të filloje më së voni më 20 qershor 2013. Pagesa e pare e pjeses së huas për bllokun 2 duhet të filloje më së voni më 20 qershor 2014.

Shkalla e kamates është shkalle e kamates variabile, që paraqet shume të EURIBOR gjashtemujor plus margjine prej 1, 675% në vit.

Neni 5

Në afat prej 30 ditesh nga data e lidhjes së Marreveshjes për hua nga neni 1, për mjetet e huas do t'i paguhet provizion i njehershem Dojce Bankes në shume prej 0,625% nga shuma e huas.

Në afat prej 30 ditesh nga data e lidhjes së Marreveshjes për hua nga neni 1 i ketij ligji dhe në daten e njejte çdo vit të ardhshem, për mjetet e huas në nivel vjetor, do t'i paguhet provizion për agjent Dojce Bankes në shume prej 9 500 eurosh, derisa huaja nuk paguhet teresisht.

Për shumen e mjeteve të paterhequra të huas nga neni 1 i ketij ligji në nivel vjetor do t'i paguhet provizion Dojce Bankes në shume prej 0,625% nga shuma e huas.

Provizioni nga paragrafi 3 i ketij neni, do të paguhet në tremujore nga data e lidhjes së Marreveshjes për hua.

Për detyrimet lidhur me pagesen e huas nga neni 1 i ketij ligji që nuk do të paguhen në afatet e parapara, do të paguhet kamate ndeshkuese në lartesi të shkalles së kamates të rritur për 2% në vit.

Për detyrimet tjera lidhur me huan nga neni 1 i ketij ligji që nuk do të paguhen në afatet e parapara, do të paguhet kompensim i demit në lartesi të shkalles së kamates të rritur për 2% në vit.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella që dalin nga Marreveshja për hua dhe Marreveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marreveshje të vecante.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.